



**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.  
e-mail.. [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
[www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)

Në bazë të vendimit të miratuar me datën 08.12.2021 nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 17.12.2021, **SHPALLË:**

## **KONKURSIN PUBLIK**

### **I. Titulli i vendit të punës: Shtëpiak në Departamentin Teknik- një (1) vend pune;**

### **II. Numri i referencës: NPL -D.M. 17/12/2021;**

### **III. Detyrat dhe përgjegjësitë:**

I kryen punët e mirëmbajtjes së rëndomtë të objektit në lëmin e profilit të punëve ndërtimore dhe zejtare si: Murosjen, suvatimin, vendosjen dhe riparimin e pllakave të qeramikës, mirëmbajtjen e kulmit të bakrit. Propozon furnizimin me material për nevojat e vendit të vet të punës.

Kontrollon të gjitha dyert dhe dritaret në nivel të objektit,

Kryen rregullimin e perdeve,

E udhëheqë ditarin e punës,

Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së kryepunëtorit dhe udhëheqësit të njësisë së higjienës dhe mirëmbajtjes.

Merr pjesë në punët ekipore të cilat janë të programuara

### **IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit**

- Kërkesa për punësim (aplikacioni); Dëshmi për shkollimin e noterizuar; përvoja e punës e vërtetuar me këto dokumente të protokolluara nga punëdhënësit ku ka punuar: vërtetimi nga punëdhënësit, kontrata e punës nga punëdhënësit ku ka punuar, si dhe referenca e punës nga punëdhënësit, kopja e trustit pensional, Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera; Kopja e letërnjoftimit; Certifikata e lindjes; Adresa e vendbanimit; Nr. i telefonit kontaktues si dhe E-maili kontaktues;

### **V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës**

Kualifikimi i mesëm i profesionit, Përvoja një (1) vjeçare në profesion.

### **VI. Kohëzgjatja e emërimit:**

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

### **VII. Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data 17.12.2021.

### **VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:**

- Aplikacionet për punësim mund të merren në ueb faqën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë si dhe fizikisht në zyrën e Departamentit të Administratës dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë.

### **IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:**

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.